

**SHPALLJA E VENDEVE TË LIRA TË PUNËS**

Tabela .1

| N r. | Pozicioni i punës                                                   | Struktura e interesuar/ Forca                         | Vendi ku ndodhet | Lloji i kontratës së punës | Procedura e përzgjedhjes së kandidatëve |            | Afati i aplikimit |            |
|------|---------------------------------------------------------------------|-------------------------------------------------------|------------------|----------------------------|-----------------------------------------|------------|-------------------|------------|
|      |                                                                     |                                                       |                  |                            | Me dosje                                | Intervista | Fillimi           | Mbarimi    |
| 1    | <b>“Zëvendës komandant skuadroni/oficer planëzues operacionesh”</b> | Reparti Ushtarak nr.3005, në Kuçovë, në Forcën Ajrore | Kuçovë           | Pa afat                    | Po                                      | Po         | 24.08.2026        | 27.08.2026 |

Formulari nr. 1

|                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                      |
|----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| <b>1.Pozicioni i punës:</b> “Zëvendës komandant skuadroni/oficer planëzues operacionesh”, në Skuadronin e Avionëve të Lehtë.                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                         |
| <b>2. Kodi i pozicionit:</b> N/A                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                     |
| <b>3. Reparti/Institucioni:</b> Reparti Ushtarak nr.3005, Baza Ajrore, Kuçovë, në Forcën Ajrore.                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                     |
| <b>4. Vendi:</b> Kuçovë                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                              |
| <b>5. Paga:</b> VKM nr.325, datë 31.05.2023, i ndryshuar.                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                            |
| <b>6. Lloji i kontratës së punës:</b> Pa afat                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                        |
| <b>7. Data e fillimit të aplikimit:</b> 24.08.2026                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                   |
| <b>8. Data e mbylljes së aplikimit:</b> 27.08.2026                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                   |
| <p><b>9. Mënyra e aplikimit:</b></p> <p>Për të aplikuar kandidatët duhet të plotësojnë formularin e aplikimit, të cilin do ta gjejnë në faqen e internetit të Ministrisë së Mbrojtjes, në adresën <a href="http://www.mod.gov.al">www.mod.gov.al</a>. Formulari pasi plotësohet, së bashku me dokumentacionin përkatës,do të dërgohet në:</p> <p><i>Drejtorinë e Burimeve Njerëzore</i></p> <p><i>Ministria e Mbrojtjes, Rruga e Dibrës</i></p> <p><i>Tiranë</i></p> |

## 10. Dokumentet e aplikimit:

Aplikantët duhet të paraqesin dokumentet e mëposhtme:

- kërkesën;
- formularin e aplikimit;
- fotokopje të kartës së identitetit;
- diplomën e shkollës së lartë të noterizuar sëbashku me listë notash;
- fotokopje të patentës nëse ka;
- dëshmi profesioni nëse ka;
- certifikatë ose dëshmi të gjuhëve të huaja
- raport mjekësor;
- fotografi me përmasa 4x6, 2 copë dhe 9x12 2 copë;
- dëshmi penaliteti;
- vërtetim nga gjykata;
- vërtetim nga prokuroria;
- librezë pune;
- jetëshkrimin (CV)
- Letër motivimi
- formularin e vetëdeklarimit, i cili gjendet në faqen e internetit të MM-së në adresën elektronike [www.mod.gov.al](http://www.mod.gov.al).(linku: *Baza ligjore/Akte ligjore/ Integriteti i personave që ushtrojnë funksione publike/formulari i vetdeklarimit*)

## 11. Kërkesat e përgjithshme të pozicionit të punës:

- a) të ketë shtetësinë shqiptare;
- b) të jetë jo më pak se 18 vjeç;
- c) të gëzojë zotësi të plotë për të vepruar;
- d) të plotësojë kërkesat për llojin dhe nivelin arsimor, si dhe të zotërojnë aftësitë profesionale të domosdoshme, për vendin përkatës të punës, sipas kriterëve të miratuara;
- ç) të jetë i aftë për punë nga ana shëndetësore;
- e) të mos jetë i/e dënuar me burg me vendim gjykate të formës së prerë për kryerje të një krimi;
- dh) të mos jetë marrë masa disiplinore me largim nga puna, brenda 1 viti nga data e aplikimit.

## 12. Kërkesat specifike të pozicionit të punës:

- a. Grada/Titulli: “Zëvendës komandant skuadroni/oficer planëzues operacionesh”, Pilot.
- b. Arsimi : Të ketë arsim të lartë/arsim ushtarak.
- c. Kualifikimi: Të ketë kualifikime në fushën e mësipërme.
- d. Trajnimi: Të ndryshme në fushën e kërkuar.
- e. Eksperienca në Punë: Të ketë eksperiencë pune si pilot në RSH, mbi 5 vite.
- f. Gjuha e huaj: Të ketë njohuri të mira të gjuhës Angleze.
- g. Kërkesa të tjera specifike: Aftësi shumë të mira të punës në grup dhe të përdor programeve kryesore të kompjuterit, Word, Excel, Power Point, Database etj.
- h. Niveli i certifikatës së sigurisë: Sipas VKM nr. 731, datë 27.11.2024 “Për miratimin e rregullores për sigurinë e personelit.

**Përshkrimi i punës:** Përgjigjet për operacionet dhe sigurinë e fluturimit, trajnimin e vazhdueshëm të ekuipazhit, për sigurinë e gjendjes së gatishmërisë së kërkuar.

**Detyrat kryesore:**

- Të asistojë Komandantin e skuadronit në punën e përditshme për organizimin e punës në skuadron.
- Të njohë nivelin tekniko-profesional të ekuipazhit në grup/skuadron.
- Të implementojë politikën e sigurisë së fluturimit në grup/skuadron, në përputhje me udhëzimet e oficerit të sigurisë fluturimit të Bazës.
- Të organizojë punën në klasat e brifingut/debrifingut për ekuipazhet.
- Të kontrollojë përditësimin e dokumenteve standarte, të përdorur nga ekuipazhet e fluturimit.
- Të monitorojë gjendjen e pajisjeve speciale individuale dhe përputhshmërinë e tyre me standartet e kërkuara.
- Të organizojë mësimet treguese me ekuipazhet nën drejtimin e komandantit të grupit/skuadronit për tema specifike.
- Të ndjekë zhvillimin e fluturimeve sipas planit të miratuar dhe t'i raportojë komandantit të grupit/skuadronit për ecurinë.
- Të kontrollojë plotësimin e regjistrit të fluturimit të grupit/skuadronit nga komandantët e ekuipazheve para dhe pas fluturimit dhe t'i raportojë komandantit të grupit/skuadronit për tema specifike.
- Mirëmban dhe ruan dokumentacionin sipas rregullave, evidenton saktësisht ndryshimet, raportimet ditore, mujore, vjetore, si dhe informacioneve periodike dhe praktikës fluturuese.
- Kryen inspektime para dhe pas fluturimeve, menaxhon seksionet e shfrytëzimit të avionëve.
- Zbaton kërkesat e rregullores zhvillimit fluturimit.

**13. Procedura e përzgjedhjes së kandidatëve:**

Përzgjedhja e kandidatëve do të bëhet nga një **komision vlerësimi** i përbërë nga 3 (tre) veta. Procedura e përzgjedhjes së kandidatëve përfshin:

- përzgjedhjen paraprake;
- vlerësimin e dokumenteve të kandidatëve, që konsiston në vlerësimin e arsimimit, të eksperiencës e të trajnimeve, të lidhura me fushën përkatëse;
- intervistën e strukturuar me gojë.

Përzgjedhja paraprake e kandidaturave do të realizohet nga Drejtoria e Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Mbrojtjes, mbi bazën e dokumentacionit të paraqitur nga kandidatët. Njësia e Burimeve Njerëzore verifikon dokumentacionin e aplikantëve, nëse ai është i plotë dhe i saktë, si dhe plotësimin e kërkesave të pozicionit të punës nga ana e tyre dhe përcakton kandidatët që plotësojnë kërkesat e pozicionit. Vetëm kandidatët që plotësojnë kërkesat e pozicionit do të njoftohen për vazhdimin e mëtejshëm të konkurimit.

Konkurimi me kandidatët që plotësonë kërkesat e pozicionit të punës përfshin:

- vlerësimin e dokumenteve të kandidatëve (vlerësimin e arsimimit/kualifikimit, vlerësimin e trajnimit dhe vlerësimin e eksperiencës të lidhura me fushën përkatëse;
- intervistën e strukturuar me gojë.

Vlerësimi i tyre do të bëhet nga komisioni përkatës.

Totali i pikëve të vlerësimit të kandidatëve është 100 (njëqind), të cilat ndahen:

- a. 40 pikë, për vlerësimin e dokumenteve të kandidatëve;
- b. 60 pikë, për intervistën e strukturuar me gojë.

**Vlerësimi i dokumenteve** të kandidatëve përfshin:

- a. vlerësimin ejetëshkrimit (CV);
- b. vlerësimin e kualifikimeve akademike, profesionale dhe teknike;
- c. vlerësimin e trajnimeve;
- d. vlerësimin e eksperiencave të ngjashme të punës;

Pikët totale të vlerësimit të dokumenteve ndahen, si më poshtë:

- a. jetëshkrimi, 5 pikë;
- b. arsimimi/kualifikimi, 15 pikë;
- c. trajnimi, 5 pikë;
- d. eksperiencia/përvoja në punë, 15 pikë.

**Intervista** zhvillohet me gojë me të gjithë kandidatët që janë përzgjedhur gjatë fazës së përzgjedhjes paraprake. Qëllimi i intervistës është të verifikojë aftësitë, motivacionin dhe aspiratat e çdo kandidati, si dhe përputhshmërinë e profilit profesional të kandidatit me pozicionin që do të mbulojë.

Intervista zhvillohet e strukturuar me qëllim që të sigurojë informacion të saktë rreth profilit profesional të kandidatëve. Ajo strukturohet në varësi të pozicionit që punonjësi do të mbulojë dhe eksperiencës.

Gjatë intervistës kandidatit i drejtohen disa pyetje nga anëtarët e komisionit, përgjigjet e të cilave vlerësohen me pikë. Çdo pyetje ka një sasi të caktuar pikësh, të cilat vlerësohen në varësi të përgjigjes. Në total intervista ka 60 pikë.

Kandidatët të cilët nuk marrin më shumë se **70 pikë**, (që përfshin vlerësimin e dokumenteve të kandidatëve, si dhe vlerësimin e intervistës), s'kualifikohen nga konkurimi.

Në mbyllje të procesit të vlerësimit, tre kandidatët që kanë marrë më shumë pikë i paraqiten autoriteteve vendimarrëse për miratimin e kandidatit më të përshtatshëm për mbulimin e pozicionit të shpallur.

Me emërimin në pozicionin e punës do të lidhet kontrata individuale e punës.